



**UNIVERSITETI I PRISHTINËS**  
**"HASAN PRISHTINA"**  
**UNIVERSITY OF PRISHTINA**

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës  
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Nr. Prot.: 1/599  
Datë: 30/09/2021

Senati i Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", në mbledhjen e mbajtur me 22.07.2021 mori vendim që të shpallë:

## **KONKURS**

### **për pranimin e studentëve në vitin e parë të studimeve master për vitin akademik 2021-2022**

1. Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina", për studimet postdiplomike-master, për vitin akademik 2021-22 do të regjistrojë **2228** studentë.
2. Në kuadër të numrit të përgjithshëm të përcaktuar si në paragrafin 1 të këtij konkursi duke u bazuar në UA nr. 09/2016 MASHT-it, Universiteti do të regjistrojë deri në **12 %**, përkatësisht deri **275** studentë të rregullt nga komuniteti jo-shumicë. Kuota prej **12%** të vendeve të rezervuara për regjistrim të studentëve nga komuniteti jo-shumicë do të shpërndahet në mënyrë proporcionale sipas përqindjes së numrit të përgjithshëm të studentëve për secilin departament apo program të fakulteteve veç e veç.

### **I. KUSHTET E PËRBASHKËTA TË KONKURISIT**

1. Në studimet postdiplomike-master në Universitetin e Prishtinës, mund të pranohen kandidatët të cilët kanë përfunduar studimet Bachelor apo studimet themelore para hyrjes në fuqi të Deklaratës së Bolonjës në të gjitha Institucionet e akredituara të Arsimit të Lartë në Kosovë. Në kushte të barabarta, përparësi në pranim do të kenë kandidatët të cilët i kanë mbaruar studimet themelore-bachelor në Universitetin e Prishtinës.
2. Të drejtë pranimi në Universitetin e Prishtinës kanë edhe të gjithë kandidatët tjerë të cilët i kanë përfunduar me sukses studimet themelore jashtë Kosovës. Në raste të tilla, kandidati duhet të sjellë dëshminë (vërtetim apo vendim) mbi akreditimin e institucionit në të cilin i ka mbaruar studimet paraprake. Në pamundësi të sigurimit të dëshmisë për akreditim, atëherë (statusi i këtyre programeve do të konfirmohet nga zyra për zhvillim akademik e cila gjendet në Fakultetin Filozofik, kati II nr.107.
3. Kandidatët të cilët kanë përfunduar studimet paraprake në një program studimi, mund të konkurrojnë për regjistrim në studimet master në një program tjetër. Në rast pranimi, Komisioni i Studimeve i njësisë akademike cakton provime diferenciale të cilave duhet t'iu nënshtrohen paraprakisht kandidatët. Komisioni i Studimeve cakton numrin e provimeve varësisht nga shkalla e krahasueshmërisë/ngjashmërisë së programit të ndjekur në studimet paraprake të kandidatit. Në raste të tilla, kandidatët ndjekin ligjëratat në vitin vijues akademik dhe iu nënshtrohen provimeve diferenciale në afatin e qershorit dhe shtatorit. Kandidatët do të kenë më së shumti deri në pesë (5) provime diferenciale të cilave do t'iu nënshtrohen para komisionit prej tre anëtarësh ndërsa procesverbalet e provimeve të tilla ratifikohen nga këshilli i njësisë akademike përkatëse.
4. Përrjashtim nga paragrafi 3 i pikës I të këtij konkursi bëhet për programet studimore me specifika të veçanta, të cilat i përcaktojnë vetë njësitë akademike.

5. Kandidatët të cilët kanë të regjistruar një program studimi në cilindo nivel të studimit në kuadër të Universitetit të Prishtinës nuk kanë të drejtë konkurrimi në program tjetër studimi në UP pa përfunduar studimet në programin ku janë duke vijuar studimet ose pa u çregjistruar nga programi aktual i studimeve.
6. Kandidatët për pranim si studentë të UP-së në vitin akademik 2021/22 nuk mund të konkurrojnë më shumë se në një fakultet, departament, drejtim apo program.

## II. MËNYRA E PËRZGJEDHJES SË KANDIDATËVE

1. Përzgjedhja e kandidatëve për të gjitha fakultetet do të bëhet sipas kritereve si në vijim:  
Numri maksimal i pikëve sipas kritereve vijuese është 100 pikë, dhe atë:
  - Suksesi në studimet themelore deri në 30 pikë;
  - Suksesi në provimin pranues deri në 70 pikë.
2. Përveç provimeve nga lëndët profesionale, kandidatët do t'i nënshtrohen testit edhe në gjuhë angleze nga i cili mund të sigurojnë deri në 10 % të pikëve të provimit pranues. Nëse kandidati dëshmon që ka certifikatë ndërkombëtare TOEFL me së paku 79 pikë (ose IELTS me së paku 5.65 pikë), i njëjti me automatizëm merr 5 pikë, ndërsa pikët tjera lidhur me gjuhën angleze shtohen varësisht nga suksesi i treguar në provimin pranues - pjesën e gjuhës angleze.
3. Përrjashtim nga paragrafi 2 i kësaj pike do të bëhet për kandidatët që aplikojnë në programet e gjuhëve të huaja në Fakultetin e Filologjisë ku provimi do të mbahet në gjuhën e programit studimor.
4. Fakultetet me specifika të veçanta organizojnë provim praktik në lëndë dhe disiplina përkatëse.
5. Të drejtë radhitjeje, përkatësisht pranimi kanë vetëm kandidatët që arrijnë 40% nga numri i pikëve të parapara për provim pranues.
6. Kandidatët të cilët nuk arrijnë 40% nga numri i pikëve të parapara për provim pranues nuk mund të pranohen edhe nëse mbeten vende të paplotësuara sipas konkursit.
7. Nëse numri i pikëve të disa kandidatë të ranguar si të fundit në listën e të pranuarve është i barabartë me kandidatë tjerë jashtë numrit të planifikuar për pranim, përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet në bazë të suksesit të provimit pranues, e nëse edhe pikët e provimit pranues janë të njëjta atëherë do të merret parasysh nota mesatare e studimeve paraprake. Në qoftë se edhe suksesi është i njëjtë, atëherë përparësi do të kenë kandidatët e gjinisë femërore. Në qoftë se kandidatët i takojnë gjinisë femërore, përzgjedhja e kandidatëve për pranim do të bëhet përmes shortit nga Komisioni i Fakultetit në prezencën e kandidatëve me pikë të barabarta. Në qoftë se kandidatët i takojnë gjinisë mashkullore, përzgjedhja e kandidatit për pranim do të bëhet përmes shortit nga Komisioni i Fakultetit në prezencën e kandidatëve me pikë të barabarta. Sekretari i fakultetit përkatës është i obliguar që listën e kandidatëve të cilët kanë konkurruar, t'ia dërgoj Rektoratit të Universitetit, e gjithashtu ta publikoj në ueb-faqen e Fakultetit.
8. Në qoftë se në afatin e parë të konkursit mbesin vende të paplotësuara për shkak që jo të gjithë kandidatët kanë arritur të kalojnë pragun minimal të pikëve, atëherë do të shpallet konkurs plotësues për plotësimin e vendeve të lira.
9. Në rast se edhe pas shpalljes së konkursit plotësues, mbesin vende të lira në kategorinë e komunitetit jo shumicë, për shkak që jo të gjithë kandidatët kanë arritur të kalojnë pragun minimal të pikëve, atëherë plotësimi i vendeve të rezervuara për komunitetin jo shumicë do të bëhet sipas ranglistës së pikëve me kandidatë që e kanë kaluar pragun e kalueshmërisë në afatin e parë të konkursit dhe që i takojnë komunitetit shumicë. Nëse nga afati i parë nuk ka kandidatë në listën e pritjes për arsye të mos arritjes së pragut të kalueshmërisë, atëherë plotësimi i vendeve të lira do të bëhet sipas ranglistës së pikëve, me kandidatë që kanë kaluar pragun e kalueshmërisë në afatin e dytë-konkursin plotësues.

10. Për funksionimin e departamentit, seksionit, degës, drejtimt ose programit të fakultetit është i nevojshëm numri minimal prej 5-10 studentëve.

### III. AFATET E APLIKIMIT DHE DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM PËR APLIKIM

**Për regjistrimin e studentëve në vitin e parë të studimeve, oraret do të jenë si në vijim:**

1. Aplikimi në platformën online <http://apliko.uni-pr.edu> dhe dorëzimi i dokumentacionit fizik nëpër fakultete do të bëhet prej datës **30.09.2021** deri më **06.10.2021** në ora 15.00 (dokumentet do të pranohen edhe ditën e shtunë).
2. **Të gjithë kandidatët të cilët aplikojnë për pranim në fakultetet e Universitetit të Prishtinës, në mënyrë që të ju lejohet hyrja në objektet e Universitetit të Prishtinës me rastin e paraqitjes së dokumenteve dhe pjesëmarrjes në provim pranues, duhet të posedojnë ndonjërin nga dëshmitë si në vijim:**
  - I. Certifikatën e vaksinimit për vaksinimin e plotë ose marrjen e një dozë të vaksinës kundër COVID-19;
  - II. Testi RT-PCR negativ për COVID-19, jo më i vjetër se 72 orë;
  - III. Dëshmi se personi ka kaluar COVID-19 (test RT-PCR pozitiv i lëshuar jo më pak se 21 ditë dhe jo më shumë se 180 ditë ose rezultat pozitiv i testit të antitropave serologjik - IgG, i lëshuar më së shumti para 30 ditëve;
  - IV. Testi shpejtë antigjen negativ jo më i vjetër se 48 orë.
3. Ditën e parë të konkursit, me datë **30.09.2021**, aplikimi online do të funksionalizohet nga ora 10.00, ndërsa pranimi i dokumentacionit në njësitë akademike do të fillojë nga ora 11.00.
4. Gjatë periudhës së aplikimi do të bëhet verifikimi i dokumentacionit nga personeli i administratës së fakultetit përkatës.
5. Kandidatëve u rekomandohet që para paraqitjes në konkurs të bëjnë kopje të mjaftueshme të dokumenteve dhe të njëjtat t'i noterizojnë (vula noterit duhet të jetë origjinale), sepse dokumentet origjinale nuk do të mund t'i tërheqin deri në diplomim apo ç 'regjistrim nga fakulteti.
6. **Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim online dhe fizik është si në vijim:**
  - a) Ekstraktin e lindjes (origjinale),
  - b) Diplomën origjinale, të noterizuar ose dublikatë, përkatësisht certifikatën e diplomimit-origjinale,
  - c) Dëshminë e akreditimit të institucionit të arsimit të lartë (për kandidatë që kanë të mbaruar studimet jashtë vendit dhe në kolegjet private të Republikës së Kosovës).
  - d) Fletëparaqitja e plotësuar e cila shkarkohet gjatë aplikimit online nga interneti: **Vegëza (Linku) për aplikim online përmes Internetit është: <http://apliko.uni-pr.edu>**
  - e) Kandidatët me rastin e aplikimit, bazuar në UA 09/2021 lirohen nga pagesa e provimit pranues.

**Provimi pranues do të mbahet më datë **08.10.2021 dhe 09.10.2021**, sipas orarit si në vijim:**

#### **Grupi I.**

1. Fakulteti Filozofik më datë **08.10.2021** në ora **9:00**
2. Fakulteti i SHMN-së më datë **08.10.2021** në ora **9:00**
3. Fakulteti Ekonomik më datë **08.10.2021** në ora **9:00**
4. Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinës më datë **08.10.2021** në ora **9:00**

5. Fakulteti i Ndërtimtarisë më datë **08.10.2021** fillon në ora **9:00-12:00**
6. Fakulteti i Arkitekturës më datë **08.10.2021** në ora **13:00.-15:00**
7. Fakulteti i Edukimit Fizik dhe i Sportit më datë **08.10.2021** në ora **8:00**
8. Fakulteti i Edukimit më datë **08.10.2021** në ora **9:00**.

### **Grupi II.**

1. Fakulteti i Filologjisë më datë **09.10.2021** në ora **9:00**
  2. Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike më datë **09.10.2021** fillon në ora **9:00-11:00**
  3. Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike më datë **09.10.2021** fillon në ora **9:00-11:00**
  4. Fakulteti Juridik më datë **09.10.2021** në ora **9:00**
  5. Fakulteti i Mjekësisë më datë **09.10.2021** duke filluar nga ora **9:00**
  6. Fakulteti i Arteve të Bukura më datë **09.10.2021**, nga ora **9:00**
1. Të gjithë kandidatët në provim pranues duhet të jenë të pajisur me maskë mbrojtëse (Vendim i Qeverisë së Republikës së Kosovës) dhe me vete të posedojnë letërnjoftimin, pa të cilin nuk mund t'i nënshtrohen provimit pranues.
  2. **Në kohën e mbajtjes së provimit pranues ndalohet përdorimi i telefonave celularë!**

## **I. SHPALLJA E REZULTATEVE PRELIMINARE**

1. **Shpallja e rezultateve preliminare** e provimit pranues do të bëhet në tabelat e shpalljeve si dhe në ueb-faqen e fakulteteve dhe atë:
  - a. Për dy grupet më së voni deri më datë **11.10.2021**, në ora **16:00**;
2. ***Me rastin e shpalljes së rezultatit preleminar nuk nënkuptohet se kandidati është pranuar, sepse pas ankesës dikush nga kandidatët mund të radhitet me lartë me pikë se kandidati i cili ishte radhitur sipas rezultatit preleminar.***

## **II. E DREJTA DHE AFATI PËR ANKESË**

1. Kandidatët të cilët sipas rezultatit preleminar renditen si kandidatë të papranuar, mund t'i paraqesin ankesë fakultetit përkatës më së largu **48 orë pas publikimit të rezultateve preliminare** (llogariten ditët e punës), respektivisht:
  - a. Për dy grupet më së voni deri më datë **13.10.2021**, në ora **16:00**
2. Pas afatit të përcaktuar si pikën e sipërshënuar. ankesat nuk do të pranohen. Shqyrtimi i ankesave bëhet, menjëherë pas mbylljes së afati ligjor për ankesa dhe atë në nivel të universitetit vetëm nga Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave nga fakulteti përkatës.

## **III. SHPALLJA E REZULTATEVE DHE PËRFUNDIMTARE**

1. **Shpallja e rezultateve përfundimtare** të provimit pranues do të bëhet në tabelat e shpalljeve si dhe në ueb-faqen e fakulteteve përkatëse, pas shqyrtimit të ankesave dhe atë:
  - 1.1. Për dy grupet më së voni deri më datë **14.10.2021**, në ora **16:00**
2. Kandidatët që nuk janë pranuar mund t'i tërheqin dokumentet e tyre në fakultetin përkatës nga data **12.10.2021-15.10.2021**.

#### IV. REGJISTRIMI I KANDIDATËVE TË PRANUAR

1. Regjistrimi dhe fotografimi i studentëve të pranuar në vitin e parë bëhet në Administratën Qendrore të Universitetit (ndërtesa e Bibliotekës Universitare), sipas këtij orari:
  - Fakulteti Filozofik më **15.10.2021** prej orës **9:00 - 12:00 dhe 13:00-15:00**;
  - Fakulteti i Shkencave Matematiko-Natyrore më **15.10.2021** prej orës **9:00 - 12:00 dhe 13:00-15:00**;
  - Fakulteti i Filologjisë më **15.10.2021** prej orës **9:00 - 12:00 dhe 13:00-15:00**;
  - Fakulteti i Arteve të Bukura më **15.10.2021** prej orës **9:00 - 12:00 dhe 13:00-15:00**;
  - Fakulteti Juridik më **15.10.2021** prej orës **9:00 - 12:00 dhe 13:00-15:00**;
  - Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike **18.10.2021** prej orës **9:00-12:00 dhe 13:00-15:00**;
  - Fakulteti i Ndërtimtarisë **18.10.2021** prej orës **9:00 - 12:00 dhe 13:00-15:00**;
  - Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike **18.10.2021** prej orës **9:00 - 12:00 dhe 13:00-15:00**;
  - Fakulteti i Arkitekturës **18.10.2021** prej orës **9:00 - 12:00 dhe 13:00-15:00**;
  - Fakulteti Ekonomik më **18.10.2021** prej orës **9:00 - 12:00 dhe 13:00-15:00**;
  - Fakulteti i Mjekësisë më **19.10.2021**, prej orës **9:00 - 12:00 dhe 13:00-15:00**;
  - Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë **19.10.2021** prej orës **9:00 - 12:00 dhe 13:00-15:00**;
  - Fakulteti i Edukimit më **19.10.2021** prej orës **9:00 - 12:00 dhe 13:00-15:00**;
  - Fakulteti i Edukimit Fizik dhe i Sportit më **19.10.2021** prej orës **9:00 - 12:00 dhe 13:00-15:00**;
2. Kandidatët të cilët nuk kanë arritur që të regjistrohen brenda afateve të përcaktuara si më sipër, mund të regjistrohen më së voni deri më **22.10.2021**, në ora **16:00**. Jashtë këtij afati kandidatët e pranuar nuk do të mund të regjistrohen për shkak të mbylljes së Sistemit për Menaxhimin e Informacionit të Arsimit të Lartë (SMIAL), prandaj luten që t'i përmbahen afatit të lartshënuar.
3. Procesi i regjistrimit të një kandidati të pranuar konsiderohet i përmbyllur në momentin e fotografimit.
4. Në qoftëse kandidati i pranuar, në afatin e caktuar nuk i përfillë të gjitha procedurat e parapara në këtë konkurs, konsiderohet se ai/ajo ka hequr dorë nga e drejta e regjistrimit. Vendet e mbetura vakant pas humbjes së të drejtës së regjistrimit, përkatësisht lëshimit të afatit si në paragrafin 3 të kapitullit V nuk do të zëvendësohen me kandidatë të cilët gjinden në listën e kandidatëve të pa pranuar.
5. Nëse numri i pikëve të disa kandidatëve të ranguar si të fundit në listën e të pranuarve është i barabartë me kandidatët tjerë jashtë numrit të planifikuar për pranim, zgjedhja e kandidatëve do të bëhet në bazë të suksesit të provimit pranues, e nëse edhe pikët e provimit pranues janë të njëjta atëherë do të merret parasysh nota mesatare e studimeve paraprake. Në qoftë se edhe sukcesi është i njëjtë atëherë përparësi do të kenë kandidatët e gjinisë femërore. Në qoftë se kandidatët i takojnë gjinisë mashkullore, përzgjedhja e kandidatit për pranim do të bëhet përmes shortit nga Komisioni i Fakultetit në prezencën e kandidatëve me pikë të barabarta.

#### V. DOKUMENTET E NEVOJSHME PËR REGJISTRIM

1. **Kandidatët e pranuar për regjistrim duhet të paraqesin:**
  - Fletëregjistrimin të plotësuar (i cili shkarkohet nga SEMS)
  - Dy fotografi formati 6x4 cm;
3. **Bazuar në UA 09/2021, kandidatët e pranuar lirohen nga pagesa për regjistrim të semestrave për herën e parë.**
  4. Për informata të tjera të nevojshme, kandidatët mund t'i drejtohen fakultetit gjegjësisht ose ta hapin faqen e internetit [www.uni-pr.edu](http://www.uni-pr.edu)

## 1. FAKULTETI FILOZOFIK

Në vitin e parë të studimeve do të regjistrojë **262** studentë dhe atë:

Departamenti-Programi	Per studime te rregullta	Kandidatë nga komunitetet jo-shumicë 12%	Gjithsej
<b>Fakulteti Filozofik</b>	<b>230</b>	<b>32</b>	<b>262</b>
<b>Departamenti i Filozofisë</b>	<b>35</b>	<b>5</b>	<b>40</b>
Programi Filozofi	35	5	40
<b>Departamenti i Historisë</b>	<b>63</b>	<b>9</b>	<b>72</b>
Programi Histori e Kohës së Re	44	6	50
Programi Arkivistikë	19	3	22
<b>Departamenti i Shkencës Politike</b>	<b>70</b>	<b>10</b>	<b>80</b>
Programi Studime Evropiane dhe administratë publike	35	5	40
Programi Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci	35	5	40
<b>Departamenti i Sociologjisë</b>	<b>44</b>	<b>6</b>	<b>50</b>
Programi Sociologji	44	6	50
<b>Departamenti Psikologji</b>	<b>18</b>	<b>2</b>	<b>20</b>
Programi Psikologji shkollore dhe këshillim	18	2	20

### ***Programi Filozofi***

- T'i kenë të përfunduara studimet themelore nga fusha e filozofisë apo shkenca humane/sociale;
- T'i nënshtrohen testimit lidhur me njohuritë profesionale nga filozofia;
- Nëse kandidati nuk ofron dëshmi për njohjen e gjuhës angleze apo të ndonjë gjuhe tjetër botërore, ai/ajo duhet t'i nënshtrohet provimit nga gjuha e huaj, që organizohet në Fakultetin Filozofik.

### ***Programi Histori e Kohës së Re***

- f) T'i kenë të përfunduara studimet themelore nga fusha e historisë;
- T'i nënshtrohen testimit lidhur me njohuritë profesionale nga studimet themelore;
- Nëse kandidati nuk ofron dëshmi për njohjen e gjuhës angleze apo të ndonjë gjuhe tjetër botërore, ai/ajo duhet t'i nënshtrohet provimit nga gjuha e huaj, që organizohet në Fakultetin Filozofik.

### ***Programi Arkivistikë***

- g) T'i kenë të përfunduara studimet themelore nga fusha e historisë apo nga shkenca humane/sociale;
- T'i nënshtrohen testimit lidhur me njohuritë profesionale nga studimet themelore;
- Nëse kandidati nuk ofron dëshmi për njohjen e gjuhës angleze apo të ndonjë gjuhe tjetër botërore, ai/ajo duhet t'i nënshtrohet provimit nga gjuha e huaj, që organizohet në Fakultetin Filozofik.

### ***Programi Studime Evropiane dhe Administratë Publike***

- T'i kenë të përfunduara me sukses studimet themelore në shkenca politike apo shkenca humane/sociale;

- T'i nënshtrohen testit të përbërë prej njohurive paraprake nga studimet themelore nga fusha: **E drejta evropiane; Institucionet, politikat dhe vendimmarrja e BE-së; Politikat e BE-së; Integrimi ekonomik evropian dhe administratë publike;**
- Nëse kandidati nuk ofron dëshmi për njohjen e gjuhës angleze apo të ndonjë gjuhe tjetër botërore, ai/ajo duhet t'i nënshtrohet provimit nga gjuha e huaj, që organizohet në Fakultetin Filozofik.

***Programi Marrëdhënie ndërkombëtare dhe diplomaci***

- T'i kenë të përfunduara me sukses studimet themelore në shkenca politike apo shkenca humane/sociale;
- T'i nënshtrohen testit të përbërë prej njohurive paraprake nga studimet themelore nga fusha: **E drejta ndërkombëtare; Politikë botërore; Institucionet, politikat dhe vendimmarrja e BE-së; Njohuri të përgjithshme nga shkencat humane/sociale;**
- Nëse kandidati nuk ofron dëshmi për njohjen e gjuhës angleze apo të ndonjë gjuhe tjetër botërore, ai/ajo duhet t'i nënshtrohet provimit nga gjuha e huaj, që organizohet në Fakultetin Filozofik.

***Programi Sociologji***

- T'i kenë të përfunduara studimet themelore nga fusha e sociologjisë **apo shkencat sociale/humane;**
- T'i nënshtrohen testit të përbërë prej njohurive paraprake nga studimet themelore;
- Nëse kandidati nuk ofron dëshmi për njohjen e gjuhës angleze apo të ndonjë gjuhe tjetër botërore, ai/ajo duhet t'i nënshtrohet provimit nga gjuha e huaj, që organizohet në Fakultetin Filozofik.

***Programi Psikologji shkollore dhe këshillimi***

- T'i kenë të përfunduara studimet themelore nga fusha e psikologjisë;
- T'i nënshtrohen testit të përbërë prej njohurive paraprake nga studimet themelore në gjuhën shqipe dhe angleze.

**2. FAKULTETI I SHKENCAVE MATEMATIKO-NATYRORE**

Në vitin e parë të studimeve do të regjistrojë **165** studentë dhe atë:

Departamenti-Programi	Per studime te rregullta	Kandidatë nga komunitetet jo-shumicë 12%	Gjithsej
<b>Fakulteti i Shkencave Matematike Natyrore</b>	<b>145</b>	<b>20</b>	<b>165</b>
<b>Departamenti Matematikë</b>	<b>18</b>	<b>2</b>	<b>20</b>
Programi Matematikë	18	2	20
<b>Departamenti Fizikë</b>	<b>18</b>	<b>2</b>	<b>20</b>
Programi Fizikë	18	2	20
<b>Departamenti Kimi</b>	<b>39</b>	<b>6</b>	<b>45</b>
Programi Kimi organike	13	2	15
Programi Kimi Analitike dhe Mjedisore	13	2	15
Programi Kimi Fizike dhe Kimi Inorganike	13	2	15
<b>Departamenti Biologji</b>	<b>52</b>	<b>8</b>	<b>60</b>
Biologji	26	4	30
Programi Ekologji dhe Mbrojtje e Mjedisit	26	4	30
<b>Departamenti Gjeografi</b>	<b>18</b>	<b>2</b>	<b>20</b>
Programi Gjeografi	18	2	20

**Provimi pranues do të mbahet nga lëndet:**

Për programin Matematikë provimi do të jetë nga Matematika;

Për programin Fizikë provimi do të jetë nga Fizika;

Për programin Gjeografi provimi do të jetë nga Gjeografia;

Për programet Biologji dhe Ekologji me mbrojtje të mjedisit provimi do të jetë nga Biologjia;

Për programet Kimi Organike, Kimi Fizike dhe Inorganike, Kimi analitike dhe Mjedisit provimi do të jetë nga Kimia.

### 3. FAKULTETI I FILOLOGJISË

Në vitin e parë të studimeve do të regjistrojë **200** studentë dhe atë:

Departamenti-Programi	Per studime te rregullta	Kandidatë nga komunitetet jo-shumicë 12%	Gjithsej
<b>Fakulteti i Filologjise</b>	<b>177</b>	<b>23</b>	<b>200</b>
Programi Gjuhë Shqipe	26	4	30
Programi Letërsi Shqipe	22	3	25
Programi Gjuhë Angleze- Programi i integruar i gjuhësisë	18	2	20
Programi Letërsi Angleze	18	2	20
Programi Gjuhë dhe Letërsi Gjermane	18	2	20
Programi Gjermanishtja si gjuhë e huaj	13	2	15
Programi Gjuhë dhe Letërsi Frënge	18	2	20
Programi Gjuhë dhe Letërsi Turke	13	2	15
Programi Studime Kulturore Orientale	13	2	15
Programi Gazetari dhe kontakte me publikun	18	2	20

**Provimi pranues do të mbahet nga lëndët:**

***Programi Gjuhë Shqipe***

1. Norma e shqipes së shkruar;
2. Fonetikë;
3. Morfologji;
4. Leksikologji;
5. Sintaksë;
6. Histori e gjuhës shqipe;
7. Sociolinguistikë; dhe
8. Psikolinguistikë.

***Programi Letërsi Shqipe***

1. Teori e letërsisë;
2. Letërsi e romantizmit shqiptar;
3. Letërsi moderne shqipe;
4. Letërsi botërore; dhe
5. Letërsi e sotme shqipe.

***Programi Gjuhë Angleze (Programi i integruar i gjuhësisë)***

1. Anglishtja për qëllime akademike;
2. Gramatikë e gjuhës angleze; dhe



3. Teori dhe praktikë e përkthimit.

**Programi Letërsi angleze**

1. Romantizmi dhe letërsia Viktoriane;
2. Letërsi moderne; dhe
3. Letërsia e Renesancës.

**Programi Gjuhë dhe Letërsi Gjermane**

1. Gjuhë gjermane;
2. Letërsi gjermane;

**Programi Gjermanishtja si gjuhë e huaj**

1. Gjuhë gjermane

**Programi Gjuhë dhe Letërsi Frënge**

1. Gjuhë frënge;
2. Letërsi frënge; dhe
3. Metodikë/didaktikë;

**Programi Gazetari dhe Marrëdhënie me Publikun**

1. Hyrje në gazetari;
2. Zhanret e gazetarisë;
3. Marrëdhënie me publikun; dhe
4. Bazat e komunikologjisë;

**Programi Studime Kulturore Orientale**

1. Qytetërim islam;
2. Kulturë orientale;
3. Historia e islamit në Ballkan;
4. Letërsia shqipe e Almiados.

**Programi Gjuhë dhe Letërsi Turke**

1. Gjuhë e sotme turke;
2. Letërsi e sotme turke;
3. Zhvillimi historik i turkologjisë.

**Vërejtje:**

- Provimi në të gjitha programet do të mbahet me shkrim.

-Të drejtë konkurrimi në studimet e nivelit MA kanë vetëm kandidatët të cilët i kanë përfunduar studimet në fusha të përafërta.

-Përjashtimisht, kandidati për pranim në programin MA Studimet kulturore orientale duhet t'i kenë përfunduar studimet themelore universitare në programet Orientalistikë, Gjuhë dhe letërsi turke, Histori, Antropologji Etnologji, Arkivistikë, Filozofi-Sociologji dhe të ketë njohuri elementare për njërin nga gjuhët arabe, turke ose perse.

#### 4. FAKULTETI JURIDIK

Në vitin e parë të studimeve do të regjistrojë **295** studentë dhe atë:

Departamenti-Programi	Per studime te rregullta	Kandidatë nga komunitetet jo-shumicë 12%	Gjithsej
<b>Fakulteti Juridik</b>	<b>259</b>	<b>36</b>	<b>295</b>
E Drejta Kushtetuese Administrative	44	6	50
E Drejta Civile dhe Pronësore	35	5	40

E Drejta Penale	44	6	50
E Drejta Ndërkombëtare	44	6	50
E Drejta Financiare	35	5	40
Kontrata dhe e Drejta Komerçiale	31	4	35
Studimet e Avancuara Evropiane (programi në Gjuhë Angleze)	26	4	30

**Provimi pranues do të mbahet nga lëndët:**

**Programi: E Drejta Kushtetuese Administrative:**

1. E drejta kushtetuese;
2. E drejta administrative;
3. Fillet e së drejtës.

**Programi: E Drejta Civile dhe e Pronës:**

1. E drejta civile (e drejta civile pjesa e përgjithshme dhe e drejta sendore) ;
2. E drejta e detyrimeve;
3. E drejta e procedurës civile (procedura kontestimore).

**Programi: E Drejta Penale:**

1. E drejta penale;
2. E drejta e procedurës penale;
3. Kriminologji dhe Penologji.

**Programi: E Drejta Ndërkombëtare:**

1. E drejta e Bashkimit Evropian;
2. E drejta Ndërkombëtare Publike
3. E drejta Nërkombëtare Private.

**Programi: E Drejta Financiare:**

1. Financat dhe e drejta Financiare;
2. Ekonomia;
3. E drejta tatimore dhe buxhetore.

**Programi: Kontrata dhe e Drejta Komerçiale:**

1. E drejta e detyrimeve;
2. E drejta tregtare (biznesore);
3. Arbitrazhi.

**Programi: Studimet e Avancuara Evropiane (programi në Gjuhë Angleze)**

1. European Union Law;
2. Public International Law;
3. Theory of International Law.

Në studimet postdiplomike-master në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës, mund të pranohen kandidatët të cilët kanë përfunduar studimet Bachelor 4 (katër vjeçar), respektivisht 240 ECTS.

Të drejtë konkurrimi kanë vetëm studentët që kanë përfunduar studimet bachelor në drejtimin përkatës (Fakulteti Juridik), me përjashtim të programit: Studimet e Avancuara Evropiane (programi në Gjuhë Angleze), ku kërkohet të ketë të përfunduar fakultetin me 240 ECTS në drejtimet: juridik, ekonomik, shkenca politike, administratë publike, filozofi dhe shkenca sociale. Provimi pranues në programin Studimet e Avancuara Evropiane mbahet në gjuhë angleze.

## 5. FAKULTETI EKONOMIK

Në vitin e parë të studimeve do të regjistrojë **400** studentë dhe atë:

Departamenti-Programi	Per studime te rregullta	Kandidatë nga komunitetet jo-shumicë 12%	Gjithsej
<b>Fakulteti Ekonomik</b>	<b>352</b>	<b>48</b>	<b>400</b>
Programi Banka dhe Financa	106	14	120
Programi Menagjment	106	14	120
Programi Marketing	70	10	80
Programi Ekonomiks	70	10	80

**Provimi pranues do të mbahet nga Lëndet:**

**Për programin Banka, Financa dhe Kontabilitetet, në lëndët:**

- a. Financa
- b. Financa të korporatave

**Për programin Menaxhment dhe Informatike, në lëndët:**

- a. Menaxhment
- b. Menaxhment I NVM-ve

**Për programin Ekonomiks në lëndët:**

- a. Mikroekonomi
- b. Makroekonomi

**Për programin Marketing në lëndët:**

- a. Marketing
- b. Sjellje konsumatori

## 6. FAKULTETI I NDERTIMTARISË

Në vitin e parë të studimeve do të regjistrojë **80** studentë dhe atë:

Departamenti-Programi	Per studime te rregullta	Kandidatë nga komunitetet jo-shumicë 12%	Gjithsej
<b>Fakulteti i Ndërtimtarisë</b>	<b>71</b>	<b>9</b>	<b>80</b>
<b>Departamenti i Konstruksioneve</b>	<b>35</b>	<b>5</b>	<b>40</b>
Programi Konstruktiv	35	5	40
<b>Departamenti i Hidroteknikës</b>	<b>18</b>	<b>2</b>	<b>20</b>
Programi Hidroteknike	18	2	20
<b>Departamenti Gjeodezi</b>	<b>18</b>	<b>2</b>	<b>20</b>
Programi Gjeodezi	18	2	20

**Për Programin Konstruktiv, Hidroteknik dhe Gjeodezi, të drejtë aplikimi kanë studentët të cilët kanë përfunduar studimet bachelor të drejtimeve përkatëse dhe kanë grumbulluar 180 ECTS.**  
 Provimi pranues do të mbahet nga fushat e studimit përkatës ku kandidatët aplikojnë.

### 7. FAKULTETI I INXHINIERISË ELEKTRIKE DHE KOMPJUTERIKE

Në vitin e parë të studimeve do të regjistrojë **90** studentë dhe atë:

Departamenti-Programi	Per studime te rregullta	Kandidatë nga komunitetet jo-shumicë 12%	Gjithsej
<b>FIEK</b>	<b>78</b>	<b>12</b>	<b>90</b>
Programi Inxhinieri Kompjuterike dhe Softuerike	26	4	30
Programi Elektronikë, Automatikë dhe Robotikë	26	4	30
Programi Teknologjitë e Informacionit dhe Komunikimit	26	4	30

#### Provimi pranues:

Për secilin nga programet e studimit provimi pranues të organizohet nga “Grup lëndësh profesionale nga fusha përkatëse e studimit”.

### 8.FAKULTETI I INXHINIERISË MEKANIKE

Në vitin e parë të studimeve do të regjistrojë **90** studentë të rregullt dhe atë:

Departamenti-Programi	Per studime te rregullta	Kandidatë nga komunitetet jo-shumicë 12%	Gjithsej
<b>Fakulteti I Inxhinierisë Mekanike</b>	<b>78</b>	<b>12</b>	<b>90</b>
Programi Termoenergjetikë dhe Energji e Ripërtëritshme	26	4	30
Programi Komunikacion rrugor	26	4	30
Programi Mekatronikë	26	4	30

Të drejtë aplikimi kane studentet që kanë përfunduar studimet bachelor ne fushën përkatëse apo të ngjashme dhe kanë grumbulluar 180 apo 240 ECTS.

Provimi pranues mbahet nga fusha e studimit përkatës ku kandidatët aplikojnë.

## 9. FAKULTETI I MJEKËSISË

Në vitin e parë të studimeve do të regjistrojë **60** studentë të rregullt dhe atë:

Departamenti-Programi	Per studime te rregullta	Kandidatë nga komunitetet jo-shumicë 12%	Gjithsej
<b>Fakulteti i Mjekësisë</b>	<b>52</b>	<b>8</b>	<b>60</b>
Fizioterapi	26	4	30
Edukimi në Kujdesin Shëndetësor MSc (120 ECTS):	26	4	30

### Kushtet për aplikim:

Të drejtë pjesëmarrje në konkurs kanë kandidatët të cilët e kanë kryer Fakultetin e Mjekësisë-niveli baçelor me sistem tre (3) vjeçar.

**Për Programin Fizioterapi:** kandidatët duhet të jenë të diplomuar në Programin: Fizioterapi.

**Për Programin Edukimi në Kujdesin Shëndetësor MSc (120 ECTS),** duhet të jetë i diplomuar në njërin prej programeve sin ë vijim: Infermieri, Mami, ose Fizioterapi.

Shpërndarja e numrit të studentëve që do të pranohen në programin: **Edukimi në Kujdesin Shëndetësor MSc (120 ECTS)**, do të bëhet si në vijim:

**Infermieri – 20 studentë, nga të cilët 18 nga komuniteti shumicë dhe 2 studentë komuniteti jo-shumicë,**

**Nga Mami – 5 studentë, nga të cilët 4 nga komuniteti shumicë dhe 1 studentë nga komuniteti jo-shumicë,**

**Nga Fizioterapi-5 student, nga të cilët 4 nga komuniteti shumicë dhe 1 studentë nga komuniteti jo-shumicë.**

**Provimi pranues** për programin Fizioterapi (MSc), mbahet në lëndët: Statistikë dhe metodologji të punës shkencore dhe Gjuhë Angleze.

**Provimi pranues** për programin Edukimi në Kujdesin Shëndetësor MSc (120 ECTS): mbahet në lëndët: Statistikë dhe metodologji të punës shkencore dhe Gjuhë Angleze dhe Kujdesi infermieror.

## 10. FAKULTETI I ARTEVE

Në vitin e parë të studimeve do të regjistrojë **166** studentë dhe atë:

Departamenti-Programi	Per studime te rregullta	Kandidatë nga komunitetet jo-shumicë 12%	Gjithsej
<b>Fakulteti i Arteve të Bukura</b>	<b>157</b>	<b>9</b>	<b>166</b>
<b>DEPARTAMENTI I ARTEVE TË BUKURA</b>	<b>44</b>	<b>6</b>	<b>50</b>
<b>Programi i Arteve vizuele</b>	<b>44</b>	<b>6</b>	<b>50</b>
Profili Pikturë	10	0	10
Profili Skulpturë	6	1	7
Profili Grafikë	6	1	7
Profili Arti Konceptual dhe Mediet e Reja	5	0	5
Profili Dizajn i Inovacioneve	8	0	8

Profili Dizajn Komunikimi	6	2	8
Profili Ilustrim dhe Vizatim	3	2	5
<b>DEPARTAMENTI I ARTEVE MUZIKORE</b>	<b>67</b>	<b>9</b>	<b>76</b>
<b>Programi Master i Muzikës në Edukim Muzikor</b>	<b>26</b>	<b>4</b>	<b>30</b>
Profili Edukim muzikor	26	4	30
<b>Programi Master i Muzikës në Performim</b>	<b>35</b>	<b>5</b>	<b>40</b>
Profili Piano	7	1	8
Profili Solo këndim	4	0	4
Profili Dirigjim	1	0	1
<b>Profili Instrumente me harqe dhe tela</b>	<b>9</b>	<b>1</b>	<b>10</b>
Moduli Violinë	2	0	2
Moduli Violë	2	0	2
Moduli Violonçelo	2	0	2
Moduli Kontrabas	2	0	2
Moduli Kitarë	1	1	2
<b>Profili Instrumentet frymore</b>	<b>15</b>	<b>2</b>	<b>17</b>
Moduli Flaut	3	0	3
Moduli Klarinetë	3	1	4
Moduli Saksafon	1	0	1
Moduli Oboa	1	0	1
Moduli Fagot	1	0	1
Moduli Trompetë	2	0	2
Moduli Trombon	2	0	2
Moduli Korne	1	1	2
Moduli Tubë	1	0	1
<b>Programi-Master i Muzikës në Kompozim</b>	<b>5</b>	<b>1</b>	<b>6</b>
Profili Kompozim	5	1	6
<b>DEPARTAMENTI I ARTEVE DRAMATIKE</b>	<b>35</b>	<b>5</b>	<b>40</b>
<b>Programi i Arteve Dramatike</b>	<b>35</b>	<b>5</b>	<b>40</b>
<b>Profili Aktrim</b>	<b>10</b>	<b>1</b>	<b>11</b>
Moduli Aktrim në Teatër	5	1	6
Moduli Aktrim në Film/TV	3	0	3
Moduli Aktrim në Performancë	2	0	2
<b>Profili Regji Filmi dhe Televizion</b>	<b>9</b>	<b>1</b>	<b>10</b>
Moduli Regji Filmi dhe Televizion	6	1	7
Moduli Regji e Filmit Dokumentar	3	0	3
<b>Profili Regji Teatri</b>	<b>4</b>	<b>1</b>	<b>5</b>
Moduli Teatri Modern	2	1	3
Moduli Teatri Eksperimental	2	0	2

<b>Profili Dramaturgji dhe Skenar Filmi</b>	<b>7</b>	<b>1</b>	<b>8</b>
Moduli Dramaturgji	2	1	3
Moduli Skenar filmi/TV	3	0	3
Moduli Huluntim teorik	2	0	2
<b>Profili Dizajn skene dhe kostumografi</b>	<b>5</b>	<b>1</b>	<b>6</b>
Moduli Dizajn skene	2	1	3
Moduli Kostumografi	3	0	3

#### **Kushtet e pranimit:**

Kandidatët të cilët konkurojnë në studime pasdiplomike – master në Fakultetin e Arteve të Bukura duhet të kenë përfunduar studimet themelore 4 vjeçare me 240 ECTS.

Pëprarësi pranimi në Fakultetin e Arteve të Bukura kanë kandidatët të cilët kanë përfunduar studimet në këtë fakultet.

Lidhur me ndërrimin e programit të studimeve në studime master vlejné dispozitat e konkursit.

**Në Departamentin e Arteve Muzikore të Fakultetit të Arteve të Bukura**, në programet performuese mund të konkurrojnë kandidatët të cilët kanë përfunduar nivelin bachelor në instrumentin përkatës apo drejtimin/profilin përkatës.

#### **Master i Muzikës në Performim- Profili:**

##### **Piano**

- J. S. Bach - 1 Prelud dhe Fugë nga WTC
- 1 Vepër virtuoze;
- 1 Sonatë klasike (Beethoven, një kohë);
- 1 Vepër madhore romantike;

##### **Solo këndim**

- 2 Arie (nga repertuari operistik);
- 2 Këngë solo (në cilëndo gjuhë);

##### **Dirigjim**

- Dirigjim i veprës për orkestër, për solist ose vokalo instrumentale; (dirigjim public ose DVD) Incizimi duhet të fokusohet në fytyrë (profil) dhe në lëvizjet e duarve të kandidatit, si dhe mundësisht edhe të një pjese të orkestrës. Incizimi duhet të dorëzohet së paku dy ditë para provimit.

##### **Harqe (violin, viole, violonçelo dhe kontrabas)**

- J. S. Bach - 1 Kohë nga Suita / Partita;
- 1 Koncert (njëkohë);
- 1 Sontë (njëkohë);
- 1 Pjesë virtuoze;

##### **Kitara**

- Bach: 2 kohë nga Partitat ose Sonatat për violin solo;
- H. Villa Lobos: 1 Etidë;
- G. Regondi: 1 Etidë;
- 1 vepër ciliklike (3 ose 4 kohëshe)

##### **Frymor (flaut, clarinet, oboa, fagot, korne, trombone, tube, trumpete);**

- 1 Koncert (komplet);
- 1 Sonatë (komplet);
- 1 Pjesëvirtuoze;

#### **Master i Muzikës - Profili:**

##### **Pedagogji e përgjithshme muzikore**

- Provim me shkrim nga lënda: **Metodika e mësimit muzikor**

- Provim me shkrim nga lënda **Harmoni Kompozim**
- Prezentimi i së paku një vepre simfonike ose vepre vokalo-instrumentale nga vet aplikuesit
- Provim me shkrim nga lënda **Kompozim** (kompozimi i veprës së përbërë 3 pjesore ose variacione mbi temën e dhënë);
- Provim nga lënda **Analizë harmonike**;

### 11. FAKULTETI I BUJQËSISË DHE VETERINARISË

Në vitin e parë të studimeve do të regjistrojë **90** studentë dhe atë në programet si në vijim:

Departamenti-Programi	Per studime te rregullta	Kandidatë nga komunitetet jo-shumicë 12%	Gjithsej
<b>Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë</b>	<b>80</b>	<b>10</b>	<b>90</b>
Programi Shkencat e aplikuara në zootekni	18	2	20
Programi Ekonomia e bujqësisë dhe ushqimit	18	2	20
Programi Mbrojtja e bimëve- Fitomedicinë	9	1	10
Programi Pemëtari me Vreshtari	9	1	10
Programi Shkenca e Ushqimit	26	4	30

**Provimi pranues do të mbahet nga lëndët profesionale të drejtimeve përkatëse.**

### 12. FAKULTETI I EDUKIMIT FIZIK DHE I SPORTIT

Në vitin e parë të studimeve do të regjistrojë **30** studentë:

Departamenti-Programi	Per studime te rregullta	Kandidatë nga komunitetet jo-shumicë 12%	Gjithsej
<b>Fakulteti i Edukimit Fizik dhe Sportit</b>	<b>26</b>	<b>4</b>	<b>30</b>
Programi Trajner Sportiv, programi 1 vjeçar	26	4	30

#### **Provimi pranues:**

Provimi pranues organizohet nga fusha e Edukimit Fizik dhe Sportit.

Kandidatët që konkurrojnë në studimet Master, duhet të kenë të përfunduar studimet themelore me 180/240 ECTS në Fakultetin e Edukimit Fizik dhe Sportit.



### 13. FAKULTETI I EDUKIMIT

Në vitin e parë të studimeve do të regjistroj **340** studentë dhe atë në programet si në vijim:

Departamenti-Programi	Për studime të rregullta	Kandidatë nga komunitetet jo-shumicë 12%	Gjithsej
<b>Fakulteti i Edukimit</b>	<b>296</b>	<b>44</b>	<b>340</b>
<b>Departamenti i Pedagogjisë</b>	<b>104</b>	<b>16</b>	<b>120</b>
<b>Programi: Master në Shkenca të Edukimit me Specializim</b>	<b>104</b>	<b>16</b>	<b>120</b>
Master në Shkenca të Edukimit: Këshillim Pedagogjik	26	4	30
Master në Shkenca të Edukimit: Edukim Inkluziv	26	4	30
Master në Shkenca të Edukimit: Mësimdhënia dhe Kurrikula	26	4	30
Master në Shkenca të Edukimit: Udhëheqja në Arsim	26	4	30
<b>Departamenti i Mësimdhënies Lëndore</b>	<b>192</b>	<b>28</b>	<b>220</b>
<b>Programi: Master i Mësimdhënies Lëndore me Specializim</b>	<b>192</b>	<b>28</b>	<b>220</b>
Master i Mësimdhënies Lëndore: Mësimdhënia e Matematikës	26	4	30
Master i Mësimdhënies Lëndore: Mësimdhënia e Fizikës	18	2	20
Master i Mësimdhënies Lëndore: Mësimdhënia e Kimisë	26	4	30
Master i Mësimdhënies Lëndore: Mësimdhënia e Biologjisë	26	4	30
Master i Mësimdhënies Lëndore: Mësimdhënia e Historisë	26	4	30
Master i Mësimdhënies Lëndore: Mësimdhënia e Gjeografisë	18	2	20
Master i Mësimdhënies Lëndore: Mësimdhënia e Teknologjisë dhe TIK-ut	26	4	30
Master i Mësimdhënies Lëndore: Mësimdhënia e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe	26	4	30

Provimi pranues dhe kushtet e aplikimit sipas programeve;

#### MASTER NË SHKENCA TË EDUKIMIT, MA 120ECTS:

- **Master në Shkenca të Edukimit: Këshillim Pedagogjik, MA 120ECTS:** Mund të aplikojnë kandidatët që kanë mbaruar studimet BA me së paku 180ECTS në drejtimet Pedagogji e Përgjithshme, Pedagogji Sociale, Pedagogji Speciale, Psikologji, Sociologji, Punë Sociale, Edukim Fillor, Edukim Parashkollor dhe Edukim në Fëmijëri të Hershme në Universitetet Publike të Republikës së Kosovës.

*Testi pranues do të organizohet nga fusha e Pedagogjisë, Psikologjisë dhe shkathtësive analitike.*

- **Master në Shkenca të Edukimit: Edukim Inkluziv, MA 120ECTS:** Mund të aplikojnë kandidatët që kanë mbaruar studimet BA me së paku 180ECTS në drejtimet Pedagogji e Përgjithshme, Pedagogji Sociale, Pedagogji Speciale, Psikologji, Sociologji, Punë Sociale, Edukim Fillor, Edukim Parashkollor dhe Edukim në Fëmijëri të Hershme si dhe në programet tjera arsimore të Universiteteve Publike të Republikës së Kosovës.

*Testi pranues do të organizohet nga fusha e Edukimit Inkluziv, Pedagogjisë, Psikologjisë dhe shkathtësive analitike.*

- **Master në Shkenca të Edukimit: Mësimdhënia dhe Kurrikula, MA 120ECTS:** Mund të aplikojnë kandidatët që kanë mbaruar studimet BA me së paku 180ECTS në Fakultetet e Edukimit si dhe në programet tjera arsimore të Universiteteve Publike të Republikës së Kosovës.  
*Testi pranues do të organizohet nga fusha e mësimdhënies/kurrikulës, pedagogjisë dhe shkathtësive analitike.*
- **Master në Shkenca të Edukimit: Udhëheqja në Arsim, MA 120ECTS:** Mund të aplikojnë kandidatët që kanë mbaruar studimet BA me së paku 180ECTS në Fakultetet e Edukimit si dhe në programet tjera arsimore të Universiteteve Publike të Republikës së Kosovës.  
*Testi pranues do të organizohet nga fusha e udhëheqjes dhe politikave arsimore, pedagogjisë dhe shkathtësive analitike.*

#### **MASTER I MËSIMDHËNIES LËNDORE:**

- **Master i Mësimdhënies Lëndore: Mësimdhënia e Matematikës, MA 120ECTS:** Mund të aplikojnë kandidatët që kanë mbaruar studimet BA me së paku 180ECTS në Fakultetin e Edukimit (Programi Matematikë-Informatikë) dhe në Fakultetin e Shkencave Matematiko- Natyrore - Dega e Matematikës.  
*Testi pranues do të organizohet nga fusha e Matematikës, si dhe nga fusha e shkathtësive analitike.*
- **Master i Mësimdhënies Lëndore: Mësimdhënia e Fizikës, MA 120ECTS:** Mund të aplikojnë kandidatët që kanë mbaruar studimet BA me së paku 180ECTS në Fakultetin e Edukimit (Programi Fizikë- Kimi) dhe në Fakultetin e Shkencave Matematiko- Natyrore - Dega e Fizikës.  
*Testi pranues do të organizohet nga fusha e Fizikës, si dhe nga fusha e shkathtësive analitike.*
- **Master i Mësimdhënies Lëndore: Mësimdhënia e Kimisë, MA 120ECTS:** Mund të aplikojnë kandidatët që kanë mbaruar studimet BA me së paku 180ECTS në Fakultetin e Edukimit (Programet Biologji-Kimi dhe Fizikë-Kimi) dhe në Fakultetin e Shkencave Matematiko- Natyrore - Dega e Kimisë.  
*Testi pranues do të organizohet nga fusha e Kimisë, si dhe nga fusha e shkathtësive analitike.*
- **Master i Mësimdhënies Lëndore: Mësimdhënia e Biologjisë, MA 120ECTS:** Mund të aplikojnë kandidatët që kanë mbaruar studimet BA me së paku 180ECTS në Fakultetin e Edukimit (Programi Biologji-Kimi) dhe në Fakultetin e Shkencave Matematiko- Natyrore - Dega e Biologjisë.  
*Testi pranues do të organizohet nga fusha e Biologjisë, si dhe nga fusha e shkathtësive analitike.*
- **Master i Mësimdhënies Lëndore: Mësimdhënia e Historisë, MA 120ECTS:** Mund të aplikojnë kandidatët që kanë mbaruar studimet BA me së paku 180ECTS në Fakultetin e Edukimit (Programi Histori- Edukatë Qytetare) dhe në Fakultetin Filozofik - Dega e Historisë.  
*Testi pranues do të organizohet nga fusha e Historisë, si dhe nga fusha e shkathtësive analitike.*
- **Master i Mësimdhënies Lëndore: Mësimdhënia e Gjeografisë, MA 120ECTS:** Mund të aplikojnë kandidatët që kanë mbaruar studimet BA me së paku 180ECTS në Fakultetin e Edukimit (Programi Gjeografi-Edukatë Qytetare) dhe në Fakultetin e Shkencave Matematiko- Natyrore - Dega e Gjeografisë.  
*Testi pranues do të organizohet nga fusha e Gjeografisë, si dhe nga fusha e shkathtësive analitike.*
- **Master i Mësimdhënies Lëndore: Mësimdhënia e Teknologjisë dhe TIK-ut, MA 120ECTS:** Mund të aplikojnë kandidatët që kanë mbaruar studimet BA me së paku 180ECTS në Fakultetin e Edukimit (Programi Teknologji-Informatikë) dhe kandidatët e tjerë nga programet e akredituara të Universiteteve Publike të Republikës së Kosovës- të cilët gjatë studimeve themelore kanë së paku 100ECTS nga Informatika (të cilën duhet ta dëshmojnë me çertifikatë të notave të studimeve themelore).  
*Testi pranues do të organizohet nga fusha e Teknologjisë, TIKut, si dhe nga fusha e shkathtësive analitike.*
- **Master i Mësimdhënies Lëndore: Mësimdhënia e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe, MA 120ECTS:** Mund të aplikojnë kandidatët që kanë mbaruar studimet BA me së paku 180ECTS në Fakultetin e Edukimit (Programi Gjuhë dhe Letërsi Shqipe) në Fakultetin e Filologjisë (Programet Gjuhë shqipe

dhe Letërsi shqipe), si dhe në programet e akredituara për Gjuhë dhe Letërsi Shqipe të Universiteteve Publike të Republikës së Kosovës.

*Testi pranues do të organizohet nga fusha e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe, si dhe nga fusha e shkathtësive analitike.*

#### 14. FAKULTETI I ARKITEKTURËS

Në vitin e parë të studimeve do të regjistroj **70** studentë dhe atë në programet si në vijim:

Departamenti-Programi	Per studime te rregullta	Kandidatë nga komunitetet jo-shumicë 12%	Gjithsej
<b>Fakulteti i Arkitekturës</b>	<b>62</b>	<b>8</b>	<b>70</b>
<b>Departamenti Arkitekturë</b>	<b>44</b>	<b>6</b>	<b>50</b>
Programi Studimor, MSc Arkitekturë, me Specializime	44	6	50
<b>Departamenti Eficienca e Energjisë</b>	<b>18</b>	<b>2</b>	<b>20</b>
Programi Studimor, MA Profesional Eficienca e Energjisë	18	2	20

**Për programin studimor, MSc Arkitekturë, me specialime** - kandidatët që kanë përfunduar studimet bachelor në fushën përkatëse dhe kanë grumbulluar më së paku 180 ECTS.

Provimi pranues do të mbahet nga fushat e studimit përkatës.

**Për programin Eficienca e Energjisë** - kandidatët që kanë përfunduar studimet bachelor në fushën përkatëse apo të ngjashme dhe kanë grumbulluar më së paku 180 ECTS.

Provimi pranues do të mbahet nga fushat e studimit përkatës.

